



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

AMSHC • Ditar Nr. 15

*Datë: 13.10.2017*

*Korrik / Gusht / Shtator / 2017*



## Konferencë Rajonale mbi Filantropinë në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, të organizuar nga TACSO

Beograd (Serbi), 4 - 6 korrik 2017

Z. Erion Banushi, Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit të Programeve, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Komunikimit, në cilësinë e përfaqësuesit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), mori pjesë në Konferencën Rajonale "Ta bëjmë të funksionojë: Filantropia në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi", të organizuar nga TACSO, e cila u mbajt në Beograd, Serbi nga data 4 – 6 korrik 2017.

Objektivat e këtij eventi ishin diskutimi i zhvillimit të përgjegjësisë sociale dhe filantropisë në rajon, duke theksuar praktikatat e mira dhe mënyrat për të forcuar filantropinë; si dhe rritja e kapaciteteve të OShC-ve për të përdorur filantropinë si një mjet për të arritur qëndrueshmëri më të madhe financiare dhe organizative.







## AMSHC vijon me organizimin e takimeve konsultative me aktorë të shoqërisë civile

Qershor - Korrik 2017

Në zbatim të Ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), ka ndërmarrë iniciativën për të realizuar takime konsultative me aktorë të shoqërisë civile përgjatë muajve Qershor – Korrik 2017.

Këto takime janë territorialisht gjithëpërfshirëse duke mundësuar edhe dëgjim të orientimeve të pjesëmarrësve mbi mënyrën dhe organizimin e proceseve administrative dhe vendimmarrëse të Institucionit; përgatitja e PBA-së, faza e dytë përsa i përket përcaktimit të produkteve, fushave të zbatimit të projekteve të financuara dhe që do të financohen.

Gjithashtu u zhvilluan edhe monitorime në terren të projekteve të financuara nga AMSHC.

Përgjatë muajit qershor janë mbajtur dy takime konsultative, e para më datë 22 qershor 2017 në qytetin e Kukësit dhe më 29 qershor 2017 në qytetin e Gjirokastrës, ndërsa takimet e radhës u mbajtën më datë 5 korrik 2017 në qytetin e Pogradecit dhe takimi përfundimtar më 15 korrik 2017 në Tiranë.



Datë 05.07.2017 - Pogradec



Datë 05.07.2017 - Pogradec



Datë 15.07.2017 - Tiranë



Datë 15.07.2017 - Tiranë



Datë 15.07.2017 - Tiranë





## Ditë trajnimi në Fondacionin Down Syndrome Albania

Tiranë, 5 korrik 2017

Ditë trajnimi në Fondacionin Down Syndrome Albania, në kuadër të zhvillimit të Projektit ***“Më mbështet, më zhvillo, më drejto për një jetë të pavarur dhe gjithëpërfshirëse - 2”***, i mbështetur nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).

## Takim i Komitetit të Përbashkët Monitorues të IPA CBC Greqi – Shqipëri 2014 - 2020

Korçë, 14 korrik 2017



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) marrin pjesë në takimin e tretë të Komitetit të Përbashkët Monitorues (JMC), në kuadër të të projektit Interreg IPA CBC "Greqi – Shqipëri 2014-2020", i cili u mbajt në ambientet e "Life Gallery Hotel" në qytetin e Korçës.

Çështja kryesore kishte të bënte me miratimin e rezultateve të fazës së dytë të procedurës së vlerësimit dhe përzgjedhjen e projekteve që do të financohen në kuadër të Thirrjes së Dytë për Propozime të Zakonshme të Projektit.

Vendimi i këtij Komiteti është i përkohshëm.

Përfituesit kryesorë do të informohen nëpërmjet postës elektronike në lidhje me rezultatet e vlerësimit sipas vendimit të KPM-së dhe mbi të drejtën e tyre për parashtrimin e ankesave zyrtare.

Pas përfundimit të kësaj procedure, rezultatet përfundimtare do të shpallen në faqen e internetit të Programit.





## Raport i DSA "Situata e shërbimeve për individët me sindromën Down"

Tiranë, 14 korrik 2017




Përfaqësuese nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mori pjesë në takimin përmbyllës të organizuar nga Fondacioni Down Syndrome Albania (DSA) në kuadër të projektit me titull "Më mbështet, më zhvillo, më drejto ndaj një jetë të pavarur dhe gjithëpërfshirëse - 2", projekt i financuar nga AMSHC dhe bashkëpunimit me Shërbimin Social Shtetëror.

Takimi përmbyllës u mbajt në ambientet e Hotel Tirana International, ku DSA paraqiti për të pranishmit objektivat kryesorë të projektit dhe prezantoi shkurtimisht "Raportin mbi shërbimet për sindromën Down".

Raporti paraqet një panoramë të situatës së përgjithshme të shërbimeve për fëmijët dhe të rriturit me sindromën Down në 16 qytete të Shqipërisë.

Përgjatë periudhës Dhjetor 2015 - Qershor 2016 ekipi lëvizës i DSA realizoi takime periodike në Kukës, Peshkopi, Pukë, Burrel, Lezhë, Fier, Fushë - Krujë, Librazhd, Tepelenë, Përmet, Gjirokastër, Durrës, ndërsa përgjatë periudhës Nëntor 2016 - Qershor 2017 u vizituan qytetet e Korçës, Vlorës, Beratit dhe Shkodrës.







## Ditës informuese mbi Thirrjen për propozime nga GIZ-ProSEED & AZHR 2

Tiranë, 24 korrik 2017



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) morën pjesë në kuadër të Ditës informuese - Thirrje për propozime “Pjesëmarrja sociale e të rinjve në nevojë dhe minoriteteve”, të organizuar nga GIZ-ProSEED së bashku me Agjencinë për Zhvillim Rajonal 2 Dibrë – Durrës – Tiranë.

Qëllimi i këtij takimi është që të informojë dhe prezantojë tek OJF-të lokale objektivin, procedurat dhe kërkesat e kësaj thirrje si dhe të nxisë pjesëmarrjen e tyre aktive në aplikim.





## AMSHC merr pjesë në pritje me rastin e Ditës Kombëtare të Zvicrës

Tiranë, 27 korrik 2017



Dita Kombëtare Zvicerane u festua në Ambasadën e Zvicrës me të ftuar, përfaqësues nga qeveria, biznesi dhe shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare dhe misionet diplomatike.

Ambasadori zviceran Christoph Graf theksoi se viti 2017 shënon një vit të veçantë për miqësinë zvicerano-shqiptare. 25 vjet më parë, në gusht 1992 u hap Ambasada Zvicerane në Tiranë. Ky ishte fillimi i një shkëmbimi intensiv dhe në rritje, bashkëpunimi dhe partneriteti. Zvicra ka mbështetur Shqipërinë në rrugën e saj drejt integritimit evropian që nga vitet '90 dhe investon më shumë se 20 milionë franga zvicerane në vit për të përmirësuar demokracinë, punësimin, infrastrukturën dhe shëndetin.

Pjesë e pritjes ishte gjithashtu një performancë e muzikës live të xhazit nga grupi zviceran Thomas Lüthi Trio.



## AMSHC merr pjesë në një sesion edukues, në kuadër të Thirrjes 10

Gjirokastër, 29 gusht 2017



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) morën pjesë në një sesion edukues të organizuar nga “Instituti i Europës Juglindore për Kontratën Shoqërore”, si pjesë e implementimit të projektit “Përmirësimi i cilësisë së jetës së grave të varfëra ose të papuna dhe i kontributit të tyre në familje dhe komunitet” të këtij instituti.

Ky projekt mbështetet financiarisht nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në kuadër të Thirrjes Nr. 10.







**amshc**

Agjencia për Mbështetjen  
e Shoqërisë Civile

## **DEKLARATË PËR SHTYP**

*Tiranë, 31 gusht 2017*

*Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) dënon ashpër aktin e vrasjes së gjyqtarës Fildes Hafizi.*

*Ky lajm shokues, ka ngacmuar dhe prekur zemrat e të gjithë shoqërisë shqiptare duke ju kujtuar se raste të tilla dhune janë të papranueshme.*

*Një grua, nënë, gjyqtare, mike e mirë dhe e dashur, humb jetën barbarisht nga manifestimi i dhunës mizore.*

*AMShC mbështet fort sjelljen etike qytetare në tërësi e në veçanti, në raport me gruan e cila mbart në vetëvete përcjellje normash etike qytetare.*

*AMShC i shpreh ngushëllime të sinqerta familjarëve të viktimës duke inkurajuar gjykatën shqiptare të vërë para drejtësisë autorin e krimit.*

Tiranë, 7 shtator 2017

Anëtarë të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) zhvilluan një takim pune, i cili u mbajt në ambjentet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.



## Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) organizon panel debati mbi gjetjet e indeksit të qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2016

Tiranë, 11 shtator 2017

Përfaqësuesi nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), z. Erion Banushi – Përgjegjës i Sektorit - Zhvillimi i Projekteve, mori pjesë në panelin e debatit mbi sfidat e shoqërisë civile, të organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), aktivitet i cili u mbajt në ambjentet e Rogner Hotel, në Tiranë.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) prezantoi gjetjet e Indeksit të Qëndrueshmërisë së OSHC-ve për Europën qendrore e lindore dhe Euroazinë - Raporti për Shqipërinë 2016.

Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve ka ndjekur statusin dhe tendencat e zhvillimit të shoqërisë civile në 29 vende për 20 vjet. Ky indeks analizon mjedisin e përgjithshëm mundësues për shoqërinë civile duke u fokusuar tek mjedisi ligjor, kapaciteti organizativ, qëndrueshmëria financiare, advokimi, ofrimi i shërbimeve, infrastruktura dhe imazhi publik.

Në këtë aktivitet morën pjesë ekspertë panelistë e përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile, të cilët diskutuan mbi tendencat, sukseset, si edhe sfidat për shoqërinë civile në Shqipëri.

